

**IEKA****INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHQIPËRISË**

Përmbledhje e të reja me të fundit

Miratohet Akti Normativ Nr. 21, datë 27.5.2020

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave Vendosi:

- Gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, gjykatat zhvillojnë seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale, duke zbatuar masat organizative specifike për zhvillimin e proceseve gjyqësore, të nevojshme për të shmangur grumbullimet në ambientet e gjykatave dhe brenda sallave gjyqësore.
- Kufizimin e hyrjes së publikut në ambientet e gjykatës, duke garantuar zbatimin e rregullave të vendosura për këtë qëllim.
- Zhvillimin me dyer të mbyllura të të gjitha seancave gjyqësore publike

Pjesëmarrja në distancë në seanca gjyqësore

1. Pjesëmarrja e të gjithë palëve të përfshirë ose të interesuar në të gjitha seancat përgatitore/gjyqësore sigurohet, atje ku është e mundur dhe vetëm pasi palët kanë dhënë pëlqimin brenda një afati të caktuar nga gjykata, nëpërmjet ndërlidhjes audiovizive në distancë, duke përdorur programe kompjuterike të përshtatshme për këtë qëllim.
2. Mënyra e ndërlidhjes në distancë duhet të sigurojë, në çdo rast, shikueshmërinë e ndërsjellë të personave të pranishëm në të dyja vendet e ndërlidhura dhe mundësinë e dëgjimit nga të gjitha palët. Nëse parashikohet pjesëmarrja e disa palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, secili prej tyre duhet të vendoset në kushte që të mund të shikojë dhe të dëgjojë të tjerët.
3. Në rastet kur seancat gjyqësore zhvillohen në distancë, provat, dokumentet shkresore si dhe çdo akt tjetër procedural i paraqiten gjykatës ose edhe palëve nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik si dhe dërgohen, brenda të njëjtës ditë, nëpërmjet shërbimit postar, me dërgesë të porositur. Dëftesa e marrjes në dorëzim duhet të ruhet nga palët deri në marrjen e vendimit të



IEKA

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHQIPËRISË

formës së prerë. Në rast se pala nuk i dërgon aktet, sipas kësaj pike, konsiderohet që ato nuk janë paraqitur.”

- Afatet që kishin filluar të llogariten sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin përkatës, por u pezulluan sipas pikës 2, të nenit 3, të aktit normativ nr.9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, vazhdojnë të llogariten nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ për pjesën e paplotësuar të afatit.
- Afatet që duhet të fillonin gjatë periudhës së pezullimit fillojnë të llogariten sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin përkatës nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ.

Aplikimet për Paketën e Zgjeruar të Ndhmës Financiare

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka njoftuar të gjithë të interesuarit se ndryshimet e fundit të VKM nr.305 datë 16.04.2020 përcaktojnë kritere të reja për përfitimin e ndihmës financiare. Sipas këtyre ndryshimeve, janë përfitues të ndihmës prej 40 000 lekësh të gjithë individët, ish të punësuarit në subjektet që janë lejuar të kryejnë aktivitetet ose janë mbyllur sipas urdhrave të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët janë larguar nga puna nga data 1 mars 2020 deri në datën 17 maj 2020.

Aplikimi për punonjësit përfitues, i kryer online, nga subjektet punëdhënëse, deri në datën 5 Qershor 2020, i përjashton ata nga penaliteti për mosaplikim. Në rast të moskryerjes së aplikimit, pas datës 5 qershor 2020, çdo subjekt që nuk ka plotësuar Kërkesën, për punonjësit e punësuar apo ish të punësuar, që plotësojnë kriteret për përfitim të ndihmës financiare, ndihmë e Qeverisë Shqiptare, **do të dënohet me gjobë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë**, në zbatim të Aktit Normativ nr.3 datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID 19”, i ndryshuar.

Të gjithë tatimpaguesit të cilët i kanë trajtuar me pagë të plotë të punësuarit apo ish-të punësuarit e tyre, nuk do jenë subjekt i këtij penaliteti. Tatimpaguesi duhet që të plotësojë formularin e ankesës, bashkëlidhur këtij njoftimi, **brenda datë 05 Qershor 2020**, dhe ta ngarkojë atë në menunë “Çështjet e Mia”, në llogarinë në e-filing. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e komunikimit të penalitetit të vendosur, çdo subjekt i gjobitur do të ketë mundësi t’i paraqesë

**IEKA****INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHQIPËRISË**

Administratës Tatimore, nëpërmjet llogarisë së deklarimit elektronik e-filing, shkaqet dhe/ose arsyet e mosaplikimit, shoqëruar me dokumentacion mbështetës që i argumenton ato.

Individëve përfitues sipas kriterëve të VKM nr.305 datë 16.04.2020, i ndryshuar, për të cilët punëdhënësi nuk do të kryejë aplikimin brenda datës 5 Qershor 2020, do t'iu jepet mundësia të plotësojnë të dhënat e tyre të llogarive bankare dhe do të vijohet menjëherë me kalimin në mënyrë automatike të masës së përfitimit pas verifikimit të kriterëve bazuar në të dhënat që administata tatimore disponon apo të dhënave që të punësuarit apo të ish-punësuarit do të dorëzojnë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve iu bën thirrje të gjithë subjekteve, të cilët plotësojnë kriteret sipas VKM nr.305 datë 16.04.2020, i ndryshuar, të plotësojnë Kërkesën për përfitim të ndihmës financiare, për individët përfitues sipas VKM të sipërcituar. Trajtimi i këtyre kërkesave do të jetë në mënyrë automatike, pra pas dorëzimit të Formularit të plotësuar, në seksionin *Statusi* shfaqet shënimi *Miraturar*, që do të thotë se kërkesa është miratur automatikisht dhe do të vijohet me pagesën e Ndihmës financiare prej 40.000 lekësh.

Dokumentat përkatëse për dorëzim të Kërkesës për Përfitim të Ndihmës Financiare sipas Paketës nr.2, të zgjeruar i gjeni në linkun:

<https://www.tatime.gov.al/d/8/45/45/1404/aplikimet-nga-subjektet-per-paketen-e-zgjeruar-te-ndihmes-financiare-do-te-pranohen-deri-ne-date-5-qershor-2020>

Plotësimi i formularit të vetëdeklarimit, në kuadër të “Shkëmbimit Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në zbatim të Ligjit Nr. 4/2020 “Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”, sjell në vëmendje të të gjithë individëve dhe tatimpaguesve të cilët zotërojnë një llogari financiare, të bashkëpunojnë me institucionet financiare përkatëse për plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, të kërkuar nga këto institucione, sipas afateve të përcaktuara nga secila prej tyre.

Mosdhënia e informacionit të mësipërm nga çdo mbajtës i llogarive të raportueshme apo person tjetër përgjegjës, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe penalizohet sipas ligjit nr. 4/2020.

Për më shumë informacion ju lutemi vizitoni seksionin “Shkëmbimi automatik i informacionit” në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.



**FOR A
GREEN
FUTURE**